

Dhomat e Specializuara të Kosovës: Komunikimi i drejtësisë ndërkombëtare

Një tjetër keqkuptim që e hasim shpesh është ideja se Dhomat e Specializuara të Kosovës janë ngritur për të gjykuar një grup të caktuar, apo për të rishkruar njëfarësoj historinë. Përkundrazi, Dhomat e Specializuara do të nxjerrin para përgjegjësisë vetëm persona për krimet që ata i kanë kryer si individë dhe nuk do të gjykojnë ndonjë grup etnik, bashkësi apo organizatë



Ekaterina Trendafilova

Për shumë vende të dala nga konflikti, gjykatat ndërkombëtare ose të "ndërkombëtarizuara" po punojnë për të dhënë drejtësi për viktimat e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Në këto shoqëri, nxjerrja e individëve para drejtësisë për krimet e tyre mund të përbëjë një pjesë shumë të rëndësishme të procesit të rimëkëmbjes dhe pajtimit.

Megjithatë, tribunale të tillë shpesh e kanë selinë larg vendit ku ka ndodhur konflikti. Zakonisht për këtë ka arsye të qenësishme, si për shembull nevoja për të garantuar sigurinë e viktimave dhe dëshmitarëve, shmangia e mundësisë së ndërhyrjeve, ose sepse krimet nën shqyrtim i kapërcejnë kufijtë ndërkombëtarë. Pavarësisht nga kjo, institucionet e zhvendosura përballen me disa sfida të veçanta gjatë shpjegimit të mandatit të tyre publikat që ndikohet më së shumti prej punës së tyre.

Si kryetare e një gjykate të tillë nga më të rejat në moshë - Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë - jam e bindur se gjykata do të kryejë procedura gjyqësore të drejta, të paanshme, të pavarura dhe të sigurta. Por, jam gjithashtu e vetëdijshme se në qoftë se njerëzit në rajon të cilët ndikohen nga gjykimet dhe vendimet gjyqësore - kryesisht në Kosovë dhe Serbi - nuk e kuptojnë se cili është mandati i institucionit tonë, atëherë nuk do ta kemi kryer plotësisht detyrën tonë.

Për këtë arsye, që në fillim, një përparësi kryesore e punës tonë ka qenë që të komunikojmë me njerëzit në Kosovë dhe rajon lidhur me punën e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe t'u japim atyre mundësinë të shprehin shqetësimet dhe të bëjnë pyetje. Ky komunikim bën të mundur që ne t'i trajtojmë disa keqkuptime që njerëzit mund t'i kenë në mënyrë të natyrshe për një gjykatë të zhvendosur në një shtet tjetër.

Për shembull, ne e theksojmë gjithmonë se Dhomat e Specializuara të Kosovës nuk janë një institucion politik. Ato janë një gjykatë ku gjykatësit do të kryejnë procedura gjyqësore të drejta dhe të paanshme. Po kështu, ne qartësojmë se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë krejtësisht të pavarura. Ato nuk marrin udhëzime nga asnjë institucion, qeveri, apo person i jashtëm.

Një tjetër keqkuptim që e hasim shpesh është ideja se Dhomat e Specializuara të Kosovës janë ngritur për të gjykuar një grup të caktuar, apo për të rishkruar njëfarësoj historinë. Përkundrazi, Dhomat e Specializuara do të nxjerrin para përgjegjësisë vetëm persona për krimet që ata i kanë kryer si individë dhe nuk do të gjykojnë ndonjë grup etnik, bashkësi apo organizatë.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të sqarojmë gjithashtu se cilat vepra penale përfshihen në juridiksionin e kësaj gjykate. Dhomat e Specializuara të Kosovës mund të gjykojnë individë për krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet tjera të parapara në legjislacionin e Kosovës të cilat pretendohet se janë kryer midis janarit 1998 dhe dhjetorit 2000, kanë nisur të kryhen ose janë kryer në Kosovë nga qytetarë të Kosovës ose të Republikës Federative të Jugosllavisë, ose janë kryer kundër shtetasve të këtyre vendeve pavarësisht nga shtetësia e autorit të krimit.

Po kështu, shpesh na bëhet pyetja se

cilat krimet konkrete të kryera me përfshirjen e cilëve individë do të gjykojë kjo gjykatë, si edhe kur do të fillojnë procedurat. Këto janë pyetje më se të kuptueshme, por janë pyetje për të cilat nuk kam përgjigje. Prokurori i Specializuar kryen hetime dhe është vendimi i tij se kundër kujt do të ngrejë aktakuzë, për cilat vepra penale konkrete, dhe kur do t'ia paraqesë aktakuzën për shqyrtim një gjykatësi të procedurës paraprake. Gjatë fazës së konfirmimit përmbajtja e aktakuzës është repletësisht konfidenciale. Në të vërtetë, aktakuzat do të bëhet publike vetëm nëse dhe kur ajo konfirmohet nga gjykatësi i procedurës paraprake.

Sidoqoftë, për një gjë jam plotësisht e bindur, se gjatë të gjitha fazave të procedurave gjyqësore do të sigurojmë që procedurat të jenë të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efektive.

Një çështje tjetër kyçe për të cilën njerëzit shpesh kanë shqetësim, është mbrojtja dhe mbështetja e dëshmitarëve. Ndonëse, për arsye sigurie nuk mund të hyj në hollësi operative, dëshiroj të theksoj seriozitetin që Dhomat e Specializuara i kushtojnë kësaj çështjeje. Gjykata ka një zyrë të specializuar e cila është tërësisht në funksion të mbështetjes dhe mbrojtjes së dëshmitarëve. Kur dëshmitarët thirren për të dëshmuar në sallën e gjyqit, gjykatësit mund të urdhërojnë një sërë masash mbrojtëse, si për shembull, përdorimi i pseudonimeve dhe shformimi i zërit dhe i pamjes së fytyrës për të garantuar që dëshmitarët të dëshmojnë në një mënyrë të sigurt, duke i dhënë përparësi sigurisë, mirëqenies, dinjitetit dhe privatesisë së tyre.

Për më tepër, shkeljet e masave mbrojtëse të bëjnë urdhëruara prej gjykatësve përbëjnë vepra penale kundër administrimit të drejtësisë në bazë të Ligjit tonë dhe Prokurori i Specializuar mund të ngrejë aktakuzat kundër kujtdo që përploqet të ushtrojë

ndikim ndaj dëshmitarëve ose të komprometojë sigurinë e tyre.

Ndoshta pyetjet më të vështira me të cilat përballemi janë ato që vijnë prej viktimave që meritojnë drejtësi dhe kanë 20 vjet e më shumë që presin këtë drejtësi. Dhomat e Specializuara të Kosovës bashkëpunojnë me grupet e viktimave dhe me shoqëritë civile për t'i informuar njerëzit për të drejtat e tyre në gjykatë, e për t'i ndihmuar të kuptojnë se çfarë kategori krimesh mund të përfshihen në aktakuzat dhe mënyrën se si ata mund të marrin pjesë në procedura.

Besoj se është e rëndësishme të shpjegojmë edhe kufizimet e mandatit të gjykatës me qëllim që njerëzit të kenë pritshmëri realiste. Në lidhje me këtë duhet theksuar se jo çdo viktimë e krimeve të luftës në Kosovë do të mund të marrë pjesë në procedura para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Personat që besojnë se janë dëmtuar drejtpërsëdrejti si pasojë e një krimi konkret të përmendur në një aktakuzë të Prokurorit të Specializuar, mund të bëjnë kërkesë për pjesëmarrje. Vendimi për dhënien e statusit si viktimë pjesëmarrëse merret nga një gjykatës. Sidoqoftë, viktimat nuk do të marrin pjesë drejtpërsëdrejti në procedurat gjyqësore. Të drejtat dhe interesat e tyre do të përfaqësohen nga mbrojtës tejet të kualifikuar.

Kam besim se Dhomat e Specializuara do të provojnë se nuk mund të ketë pandëshkueshmëri për krimet e rënda që u kryen në Kosovë gjatë periudhës 1998-2000 dhe se, edhe pas 20 vjetësh, ata individë për të cilët dyshohet se kanë kryer krimet brenda mandatit të Dhomave të Specializuara, do të dalin para drejtësisë.

Autorja është Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës